



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0453

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) GROWECO SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim dhe renovim të brendshëm në objektet e Institucioneve Edukativo Arsimore(dyer dhe dritare) me numër të prokurimit 613-25-1505-1-2-1, më 16.09.2025 mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE GROWECO SH.P.K., me nr. 2025/0453, e datës 05.06.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim dhe renovim të brendshëm në objektet e Institucioneve Edukativo Arsimore(dyer dhe dritare) me numër të prokurimit 613-25-1505-1-2-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Furnizim dhe renovim të brendshëm në objektet e Institucioneve Edukativo Arsimore(dyer dhe dritare) me numër të prokurimit 613-25-1505-1-2-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik GROWECO SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 11.03.2025 KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Furnizim dhe renovim të brendshëm në objektet e Institucioneve Edukativo Arsimore (dyer dhe dritare) me

numër të prokurimit 613-25-1505-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 60,000.00 Euro.

Me 21.05.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ku ka shpërblyer me kontratë OE Tala Engineering Sh.P.K.

Me 24.05.2025, OE GROWECO SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 27.05.2025.

Me 05.06.2025, OE GROWECO SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0453, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik GROWECO SH.P.K., lidhur me ankesën 0453/2025:

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Me datën 02.04.2025 Afati për dorëzimin e ofertave përmes platformës elektronike e prokurimit.

Ofertues 2 kompani

Ne si Groweco Shpk kemi ofruar çmimin më të lirë 54,040.00 Euro.

Si dhe Tala Engineering Shpk me çmim prej 59,790.00 Euro.

Me datën 14.04.2025 AK, përmes sistemit e-prokurimi dhe letrës standarde ka kërkuar dokumentet e përshtatshmërisë. Po ashtu në të njëjtën datë ne si OE i kemi dorëzuar dokumentet e kërkuara.

Me datën 17.04.2024 njoftohemi se ne si OE Groweco Shpk jemi propozuar për kontratë.

Me datën 28.04.2025 njoftohemi për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Me datën 30.04.2025 AK njofton për aprovimin e kërkesës për rishqyrtim të "Tala".

Me datën 21.05.2025. Përmes platformës elektronike të KRPP-së njoftohemi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, se për aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim dhe renovim të brendshëm në objektet e Institucioneve Edukativo-Arsimore (dyer dhe dritare), me numër të prokurimit 613-25-1505-1-2-1., është shpallur fitues Tala Engineering Shpk.

Të pakënaqur me këtë vendim, në bazë të dispozitave të LPP-së, kemi bërë kërkesë për qasje në dokumentacionin e tenderit fitues me dt. 21.05.2025. Me datën 22.05.2025 na është ofruar qasje në dokumentacionin e tenderit, me ç'rast konstatojmë se:

Gjatë vlerësimit të tenderit Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP-së respektivisht Neni 6, Neni 7, Neni 52, Neni 59, Neni 60, Neni 69, dhe Neni 72.

Pretendimi i Parë – Provë materiale / Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacionet shtesë

Në letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm, AK ka përmendur: Në listën e punëtorëve të paraqitur nga ana e tenderuesit nuk ekziston pozicioni:

a) Minimum një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi Konstruktiv, sistemi 5-vjeçar apo master (min. 2 vjet përvojë pune pas diplomimit) të jetë i certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, po ashtu i njëjti të caktohet nga OE për menaxher të këtij projekti.

Ky pretendim nga ana e AK nuk është aspak i vërtetë.

Sipas Lidhjes së Ofertës:

- Dokumenti nr. 2: Menaxheri i projektit
- Dokumenti nr. 7: Lista e punëtorëve

Dokumentet tona të dorëzuara (kontrata, diploma, CV, certifikata për siguri dhe shëndet në punë, dhe vendimi për menaxher të projektit, Lista) për pikën “a” të dosjes së tenderit, vërtetojnë se i njëjti do të angazhohet si staf i kompanisë dhe do të jetë menaxher i projektit. Ky fakt është deklaruar dhe dokumentuar qartë në dokumentacionin dhe faktet tona të ngarkuara.

Në rast të paqartësive, Autoriteti Kontraktues, në pajtim me Nenin 72 (Dokumentacioni dhe informacionet shtesë) po ashtu edhe me Rregulloren Nr. 001/2022 për prokurimin publik, Neni 40 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, dhe 40.8: “Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht të sqarojë tenderin e tij / saj sipas nenit 38 të kësaj rregullore.”

AK kishte mundësinë dhe obligimin që të kërkonte një sqarim shtesë, çka nuk është bërë. Kjo përbën një mospërputhje me Nenin 72 dhe Nenin 40 të Rregullores Nr. 001/2022 të LPP-së, që kërkon trajtim të drejtë, të barabartë dhe jo-diskriminues ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Pretendimi i Dytë – Provë materiale / Neni 7, Neni 69

- Neni 7 – Barazia në trajtim / Jo diskriminimi dhe transparenca
- Neni 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale

Në dosje të tenderit është kërkuar:

Kërkesa 3: Minimumi 2 punëtorë të jenë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë.
Dëshmia 2: Të dëshmohet me CV dhe certifikatë të noterizuar sipas kërkesës.
Për të gjithë stafin kërkohen kontratat e punës ose parakontrata për këtë projekt.

OE i rekomanduar për kontratë TALA ENGINEERING SHPK, në bazë të dëshmive të ofruara ku ka paraqitur këtë listë, mungon certifikata për siguri dhe shëndet në punë:

1. Ardian Bajrami – profesioni: Punëtor, pozita në kompani: Punëtor
2. Fadil Bajrami – profesioni: Punëtor, pozita në kompani: Punëtor

Ka ofruar vetëm kontratë dhe CV të noterizuar.

Në bazë të listës së ofruar, nuk ka specifikuar se të dy punëtorët e lartcekur janë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë, por vetëm punëtorë të thjeshtë.

Nga cila dëshmi është thirrur Autoriteti Kontraktues që në Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë të ofrojë dëshmi shtesë?

Ndërsa neve nuk na është dhënë kjo mundësi, ndonëse dokumentet tona kanë qenë të plota dhe të vlefshme.

Andaj Autoriteti Kontraktues është dashur që OE e rekomanduar ta marrë si operator të përgjegjshëm, për arsye se nuk ka punëtorë të kualifikuar për këtë projekt.

Kjo përbën jo trajtim të barabartë dhe shkelje të parimit të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë sipas Neni 7 dhe Neni 69 të LPP-së.

Pretendimi i Tretë – Provë materiale / Neni 7, 52, 59, 60

- Neni 7 – Barazia në trajtim / Jo diskriminimi dhe transparencë
- Neni 52 – Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës
- Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 – Kriteret për dhënien e kontratës

Seksioni II – Fleta e të dhënave të tenderit (FTD), faqja 12, pika 3.1 – Specifikimet teknike të detyrueshme:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:

a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Citojmë:

“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”

Sipas pikës 3.1 të specifikimeve teknike të detyrueshme, operatori ekonomik është dashur të nënshkruajë dhe vulosë Aneksin 1.

Kompania Tala Engineering, e propozuar për kontratë, në bazë të dokumenteve të dorëzuara nuk e ka bërë këtë, dhe për këtë arsye Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar ta shpallë si operator të përgjegjshëm dhe të ndërpresë vlerësimin e mëtejshëm, në përputhje me nenet 7, 52, 59, 60 të LPP-së.

Ne si OE Groweco Shpk jemi përshtatur dhe kemi nënshkruar dhe vulosur dokumentin e kërkuar sipas kërkesës në dosjen e tenderit, po ashtu argumentohet edhe në dokumentacionin e ngarkuar në lidhjen e ofertës dokumenti me numër 3 dhe 10.

Pretendimi i Katërt – Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Në përputhje me Nenin 6 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, autoritetet kontraktuese janë të detyruara të zbatojnë parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit, duke siguruar që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrën më të drejtë dhe të arsyeshme të mundshme.

Në rastin konkret, kompania jonë si OE ka ofertuar me çmimin prej 54,040.00 €, ndërsa kompania Tala Engineering Shpk ka ofertuar me çmimin 59,790.00 €.

Megjithë diferencën prej 5,750.00 € në disfavor të buxhetit publik, Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim që t'ia japë kontratën ofertës më të shtrenjtë, pa ndonjë arsyetim të qartë që do të justifikonte shmangien nga oferta më ekonomike.

Ky veprim bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Nenin 6, i cili kërkon që çdo vendim të përfaqësojë përdorimin optimal të burimeve publike, duke maksimizuar vlerën për parane dhe minimizuar shpenzimet e panevojshme.

Përfundimisht:

Kërkojmë nga ju që të anuloni njoftimin mbi vendimin e AK të datës 21.05.2025, dhe AK të kthehet në vendimin e datës 17.04.2025, dhe ne të shpallemi fitues, pasi ne si OE jemi me të gjitha dokumentet në rregull. Ndërsa OE i propozuar për kontratë, në bazë të argumenteve të paraqitura, është administrativisht i papërgjegjshëm.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori Ekonomik Greveko SH.P.K, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim dhe renovim të brendshëm në objektet e Institucioneve Edukativo Arsimore (dyer dhe dritare)” me Nr. të Prok: 613-25-1505-1-2-1-1, më datë 24.05.2025.

Autoriteti Kontraktues, me datë 26.05.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: Sa i përket pretendimit të parë se tenderuesi ankues është i përgjegjshëm dhe se ka prezantuar dokumentacionin e kërkuar nuk qëndron. Në listën e punëtorëve të cilën e ka ofruar tenderuesi ankues nuk është emri i ing., cili me vendim caktohet menaxher i kontratës. Me ç'rast sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, rregullon këtë çështje.

Në bazë të rregullave të prokurimit publik, analogji: lista e kontratave të realizuara nuk përmbushë kërkesat të vlerës së përcaktuar - refuzo tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshme. Të bashkangjitur pjesën nga rregullorja.

Gjithashtu për këtë kemi vendimin e OSHP nr. OSHP: 2025/0069, të datës: 11.04.2025, pjesë nga Vendim: Përgjigje në pretendimin ankimor 2, të lartcekur: 59 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve) Përgjigjja e ekspertit shqyrtues pas shqyrtimit dhe kontrollimit të rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar është se, Autoriteti Kontraktues nuk e ka bërë Ekzaminimin, Vlerësimin dhe

Krahasimin e Tenderëve, në pajtim me nenin 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”

Inxhinieri i prezantuar (B.H) nga tenderuesi është i përgjegjshëm sepse nuk është i përfshirë fare në Listën e Stafit - nga OE N>N. dhe AK - komisioni vlerësues pa të drejtë e ka kualifikuar të përgjegjshëm.

Sipas nenit 72. Pika 3 të Ligjit Nr. 04/L-042, PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), citoj:

“Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.”

Bazuar në nenin 38.3 të Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022, Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.

Në këtë rast ju keni paraqitur Listën e Stafit, por nuk keni pasur punëtorin në listë, punëtorin në fjalë, dhe bazuar në dispozitat e lartcekura AK nuk ka pasur të drejtë të kërkojë ndonjë listë shtesë. Në rast se OE nuk kishte paraqitur fare listë, AK ka qenë i detyruar të kërkojë listën, por JU keni paraqitur listë gjysmake në të cilën listë nuk ka figuruar fare punëtori në fjalë.

Pretendimi i dytë se tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm nuk qëndron, lista e punëtorëve është sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues dhe me sqarimin e kërkuar ndaj OE, të cilin e keni pranuar edhe Ju në qasje, ka bërë plotësimin e dokumentacionit të kërkuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 09.06.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0453, ndërsa me datë 19.06.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0453. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEGROWECO SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0453, ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigjeje ne pretendimin 1 *Sa i përket pretendimit 1 si ekspert shqyrtues konstatoj se OE ankues është i përgjegjshëm ne baze kërkesave te dosjes se tenderit: Kërkesa 2 Stafit profesional. a) Min Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi Konstruktiv, sistemi 5 vjeçar apo master (min. 2 vjet provojë pune pas diplomimit) te jete i certifikuar për siguri dhe shëndet ne pune po ashtu i njëjti te caktohet nga OE për menaxher te këtij projekti. Gjithashtu si ekspert shqyrtues konstatoj se është shkelur nenin 59 dhe 60 nga AK-ja siç pretendon OE ankues, këtë e mbështeti duke u bazuar se OE ankues GROWECO SH.P.K., ka dorëzuar me oferte Diplomën për Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi Konstruktiv për menaxherin e Projektit z. Fatmir Krasniqi gjithashtu po i njëjti person është i certifikuar për siguri dhe shëndet ne pune qe ne baze te dëshmive si ekspert shqyrtues konstatoj se i ka përmbushur kriterin e dosjes se tenderit 9.1&9.2 dhe është i përgjegjshëm. Arsyet e eliminimit nga AK KK Lipjan nuk qëndrojnë pasi Listën e punëtorëve e ka te dorëzuar, ndërsa Dëshmitë për Menaxherin i ka ne Oferte ne faille te veçante ashtu është edhe kërkesa e Dosjes se tenderit. Pretendimi është i bazuar.*

Përgjigjeje ne pretendimin 2 *Ne baze te dëshmive te Ofruar me ofertë nga OE i rekomanduar për kontratë shihet se e ka dorëzuar punëtorët i ka dorëzuar certifikuar për siguri dhe shëndet ne pune për inxhinierin konstruktiv e kërkuar , mirëpo AK-ja ja ka kërkuar sqarime ne baze te nenit 72 certifikatat për dy punëtorët Ardian Bajrami, Fadil Bajrami dhe certifikatat lejohet te kërkojnë ne baze te nenit 72 pasi certifikatat janë te lëshuar para dorëzimit te ofertave.*

Kompania ankuese është diskriminuar pasi kërkesat i ka plotësuar per Inxhinierin Konstruktiv dhe ne baze te kësaj konstatoj se AK-ja nuk ka vlerësuar ne përputhje me nenin 7 dhe 59 te LPP-se, konstatimi është pjesërisht i bazuar

Përgjigjeje ne pretendimin 3 *Pretendimi për deklaratën e specifikimeve teknike qe nuk e ka dorëzuar OE i rekomanduar , si ekspert konstatoj se nuk ka qene kërkesë e dosjes se tenderit te dorëzohet deklarata e specifikimeve teknike dhe nuk duhet te ngritën pretendime për kriteret te cilat nuk janë pjese e dosjes se tenderit. Pretendimi nuk është i bazuar.*

Përgjigjeje ne pretendimin 4 *Ndërsa sa i përket pretendimit se është shkelur neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti si ekspert shqyrtues konstatoj se kompania ankuese është me çmim me te ulet qe duhet te konsiderohet se është me e favorshëm për rekomandim te kontratës dhe AK-ja jane te detyruara te zbatojnë parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit, duke siguruar qe fondet publike te shfrytëzohen ne mënyrën me te drejte dhe te arsyeshme te mundshme pasi ka ofruar me çmim me te ulet 5,750.00. Gjithashtu si ekspert shqyrtues konstatoj se është shkelur edhe neni 60 i LPP-se pasi është me çmim me te ulte. Pretendimi është i bazuar.*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësia e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkojnë nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim dhe renovim të brenshëm në objektet e Institucioneve Edukativo Arsimore (dyer dhe dritare) me numër të prokurimit 613-25-1505-1-2-1.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka vepruar në harmoni me nenin 72 të LPP

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të kontratës dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - GROWECO SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: